

## Merkblatt **Kontributi i Qytetit në përkujdesjen e fëmijëve**

Të dashur prindër,

Fëmija Juaj është në përkujdesje të ndonjë çerdheje ditore apo të ndonjë familjeje ditore në Winterthur dhe Ju gëzoni të drejtën e kontributeve të Qytetit. Kontributet e Qytetit në kuadër të përkujdesjes plotësuese familjare në moshën parashkollore dhe në familjet ditore janë rregulluar në bazë të Urdhëresës së çerdheve ditore dhe të Rregullores së çerdheve. Këto mund të gjenden në <https://stadt.winterthur.ch/erlasse> Band 4: Departement Schule und Sport (pjesa 4: Departamenti Shkolla dhe Sporti).

Në këtë fletinformim janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur informacionet më të rëndësishme të ciat duhet t'i keni parasysh në lidhje me kontributin e Qytetit. Informacione të tjera dhe formularët lajmërues i gjeni në <https://stadt.winterthur.ch/kinderbetreuung>.

### **Llogaritari për llogaritjen e kontributeve të prindërve për çerdhet ditore (nuk vlen për familjet ditore)**

Me llogaritarin online Ju mund të llogaritni në mënyrë joobligative kontributin e Juaj prindor për përkujdesje në ndonjë çerdhe ditore. Llogaria definitive pason pas lajmërimit. Llogaritarin e kontributit mund ta gjeni në

<http://stadt.winterthur.ch/kinderbetreuung/kosten-und-staedtische-beitraege>

Kontributi Juaj varet nga të ardhurat e Juaja tatimore dhe nga pasuria Juaj dhe nga tarifa ditore e çerdhës përkatësisht nga tarifa ditore e familjes ditore të Winterthur-it.

### **Parakushtet për të gëzuar të drejtën e kontributeve për përkujdesje të Qytetit**

- Ju banoni në Qytetin e Winterthur-it
- Të ardhurat tatimore përfshirë 10% të pasurisë tatimore të të autorizuarve për edukim, që banojnë në të njëjtën amvisëri, janë max. Fr. 100'000.
- Ju jeni i angazhuar profesionalisht gjatë kohës sa fëmija Juaj është nën përkujdesje
- Apo Ju ndiqni ndonjë shkollim apo shkollim të mëtejshëm\*
- Apo Ju jeni i paangazhuar profesionalisht dhe merrni ndihma sociale dhe përkujdesja për fëmijët i shërben mbajtjes së aftësisë së Juaj ndërmjetësuese\*
- Apo fëmija Juaj ka ndonjë nevojë të veçantë për përkrahje të hershme dhe për integrim social\*
- Apo Ju si i autorizuar për edukim jeni regjistruar si i sëmurë \*

\* Të gjitha këto raste duhet t'ia dëshmoni çerdhës ditore përkatësisht Zyrës për çështje të udhëheqjes së "Familjeve ditore" me të gjitha dëshmitë me shkrim.

### **Lajmërimi dhe kërkesa për kontributin e qytetit për përkujdesje të fëmijëve**

Lajmërojeni fëmijën e Juaj në çerdhën ditore apo në Zyrën për udhëheqje të "Familjeve ditore" Winterthur dhe plotësojeni formularin për lajmërim si dhe kërkesën për marrjen e kontributit për përkujdesje të Qytetit të Winterthur-it. Çerdhja përkatësisht Zyra për udhëheqjen e "Familjeve ditore" do t'i memorojë të dhënat e Juaja në një softuer special. Qyteti i Winterthur-it, Zyra profesionale për përkujdesje për fëmijë të moshës parashkollore, i plotëson të dhënat e Juaja në bazë të të dhënave nga Zyra tatimore dhe nga Zyra e regjistrimit të banorëve dhe e bën të njohur kështu kontributin e Juaj dhe kontributin e Qytetit.

**Çvendosja nga ndonjë kanton tjetër apo nga shtetet e tjera; tatimpaguesit e tatimit në burim; ndarja apo shkurorëzimi**

Në rast se në Kantonin e Cyrihut nuk jeni ende i klasifikuar definitivisht në aspektin tatimor, Qyteti i Winterthur-it bën një simulim tatimor për të përcaktuar kontributin e Juaj prindor. Për këtë qëllim duhet t'i dërgoni në mënyrë elektronike apo me shkrim Zyrës për përkujdesje të fëmijëve në moshën parashkollore ("Fachstelle Kinderbetreuung im Vorschulalter"), Pionierstrasse 7, 8403 Winterthur, kinderbetreuung@win.ch këto dokumente:

- listat aktuale të rrogave të të gjithë të autorizuarve për edukim që jetojnë në të njëjtën amvisëri, dëshminë e pasurisë (p.sh. ekstraktin e kontos)
- apo klasifikimin tatimor nga ndonjë kanton tjetër
- apo vërtetimin mbi ndihmën sociale
- një kopje të kërkesës së plotësuar për kontributet e përkujdesjes për fëmijë të Qytetit

### **Rillogaritja e kontributeve prindore**

Ju jeni të obliguar që ndryshimet prej më shumë se 20% të të ardhurave tatimore t'ia paraqisni çerdhës ditore. Në një rast të tillë bëhet rillogaritja e kontributit.

Qyteti i Winterthur-it i rishikon rregullisht kontributet prindore dhe sipas nevojës bën edhe rillogaritjen e tyre. Në rast se të ardhurat e Juaja janë më të larta se 20%, kërkohet kthimi i kontributit të paguar të Qytetit. Çerdhet ditore lajmërojnë Qytetin e Winterthur-it, në rast se kanë të dhëna për atë se të ardhurat dhe pasuria Juaj janë më të larta. Në rast se të ardhurat dhe pasuria Juaj janë më të ulëta, kontributi i paguar prindor nuk kthehet.

Pas çdo rillogaritjeje Ju do të merrni edhe marrëveshjen e re të përkujdesjes.

### **Kontributet për përkujdesje të pjeshme apo në rast se nuk kërkohet kontributi**

Ju keni mundësi që fëmijën ta keni edhe në përkujdesje të pjeshme. Në formularin lajmërues për çerdhen ditore përkatësisht për familjen ditore Ju e bëni me dije edhe nevojën për përkujdesje. Përkujdesja ditore nuk guxon ta kalojë për më shumë se 3 orë numrin e orëve të Juaja ditore të punës.

Nëse fëmija Juaj është i sëmurë apo për ndonjë arsye tjetër nuk mund të jetë nën përkujdesje ashtu siç e rregullon marrëveshja, kontributi Juaj për çerdhen ditore nuk do të reduktohet. Për familjet ditore vlejnë rregulla të tjera për të cilat mund të informoheni nga "Zyra për udhëheqje të familjeve ditore".

### **Të dhënat e mangëta apo të gabueshme**

Ne ju bëjmë me dije për atë se jeni të obliguar që të gjitha informacionet t'i jepni në përputhje me të vërtetën. Në rast se vërtetohet se keni dhënë të dhëna jo të plota apo të gabueshme, do ta humbni të drejtën për kontribute të Qytetit. Çerdhja ditore përkatësisht „Zyra për udhëheqjen e familjeve ditore“ vendos për atë se a të pranohet fëmija Juaj me tarifë të plotë apo jo.

Për pyetje të tjera Ju lutemi drejtohuni çerdhes ditore, "Zyrës për udhëheqje të familjeve ditore" apo

### **Qytetit të Winterthur-it**

Departamentit Shkolla dhe Sporti Zyra profesionale për përkujdesje parashkollore Pionierstrasse 7, 8403 Winterthur Telefon 052 267 68 15 <a href="mailto:kinderbetreuung@win.ch">kinderbetreuung@win.ch</a> <a href="http://www.stadt.winterthur.ch/kinderbetreuung">www.stadt.winterthur.ch/kinderbetreuung</a>	Stadt Winterthur, Departement Schule und Sport Fachstelle Kinderbetreuung im Vorschulalter Pionierstrasse 7, 8403 Winterthur Telefon 052 267 68 15 <a href="mailto:kinderbetreuung@win.ch">kinderbetreuung@win.ch</a> <a href="http://www.stadt.winterthur.ch/kinderbetreuung">www.stadt.winterthur.ch/kinderbetreuung</a>
---	---